



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 662 prot.

Tiranë, më 02. 3 .2023

V E N D I M

Nr. 17 , datë 27.02 .2023

**“Për një ndryshim në Rregulloren e Universitetit të Tiranës”**

Bazuar në nenin 75/6, të ligjit të arsimit të lartë; nenin 93 të Statutit Universitetit të Tiranës; nenin 103, të Rregullores së Universitetit të Tiranës, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës, pas shqyrtimit të kërkesës së disa anëtarëve të Senatit Akademik dhe propozimit të Rektorit, për ndryshimin e pikës 4, 5, 6, të nenit 67, të Rregullores së UT-së, në mbledhjen e datës 27.02 .2023,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë ndryshimin e pikës 4, 5, 6, të nenit 67, të Rregullores së UT-së, si vijon:

*“4. Studimet e ciklit të dytë “Master i shkencave” përmbillen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë “Master i shkencave” në fushën e arsimimit të kryer. Studimet e ciklit të dytë “Master profesional” përmbillen me punim diplome ose provim përfundimtar formimi dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë “Master profesional” në fushën e arsimimit të kryer. Kur detyrimi përmbyllës i programit të studimeve të ciklit të dytë bëhet me punim diplome, punimi i diplomës përllorëritet me numër kreditesh ECTS sipas kuadrit ligjor apo nënligjor që rregullon elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL-të, të cilët parashikohen edhe në planin mësimor.*

*5. Për programin e studimit Master Ekzekutiv, punimi i diplomës përllorëritet me numër kreditesh ECTS sipas kuadrit ligjor apo nënligjor që rregullon elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL-të, të cilët parashikohen edhe në planin mësimor.*

*6. Në programin e integruar të studimeve, punimi i diplomës përllorëritet me numër kreditesh ECTS sipas kuadrit ligjor apo nënligjor që rregullon elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL-të, të cilët parashikohen edhe në planin mësimor.”*

2. Vendimi i përcillet të gjitha njësjive përbërëse të Universitetit të Tiranës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

